



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komuna Podujevë shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Emri i grupit</b>	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm
<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zyrtar për Gjendje Civile 4
<b>Klasa e pozitës</b>	Profesional 3
<b>Koeficienti/Paga</b>	3.96
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	09/02/2024
<b>Afati për aplikim</b>	10/02/2024 - 10/03/2024
<b>Institucioni</b>	Komuna Podujevë
<b>Departamenti</b>	Drejtoria e Administratës
<b>Divizioni</b>	
<b>Vendi i punës</b>	Shërbimi i Gjendjes Civile
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00013291
<b>Kodi</b>	RPC0006830



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me udhëheqësin për zbatimin e objektivave në realizimin e shërbimeve ndaj qytetareve në fushën e gjendjes civile;
2. Pranon kërkesat e palëve për korrigjimin e gabimeve të cilat kanë ndodhur me rastin e regjistrimit në librat amë, ndërrimin e emrit dhe mbiemrit dhe regjistrime të mëvonshme në librat amë të lindurve;
3. Bënë regjistrimin e ngjarjeve të gjendjes civile në librat amë përkatës, të lindjes, martesës dhe vdekjes si dhe përgatit regjistra sipas kërkesave të drejtoritve komunale lidhur me gjendjen civile;
4. Kryen shërbime sipas kërkesave të qytetareve për lëshimin e certifikatave të lindjes, të vdekjes dhe martesës; vërtetim mbi statusin martesor; vërtetimin që personi është në jetë (gjallë); certifikata mbi gjendjen familjare;
5. Pranon raporte të ndryshme nga komunat tjera për ndryshime në librat amë si dhe përcjellë raporte të ndryshme komunave tjera;
6. Përpilon dhe plotëson deklaratatë të ndryshme dhe merr në pyetje dëshmitarët në prezencën e palëve për lloje të ndryshme të regjistrimeve apo lëshuarjen e vërtetimeve;
7. Mirëmban dhe ruan regjistrat e ndryshme dhe librat amë të lindjes, vdekjes dhe martesës;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve.
- **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Nuk kërkohet.



## 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikatat operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).

## 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Vërtetimin për zotësinë e plotë të veprimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Certifikatën që dëshmon se nuk jeni i denuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale (origjinali) - (pas pranimit në punë)
- Certifikatën shëndetësore - (pas pranimit në punë)
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende (nëse aplikuesi ka punuar ose punon në institucione publike)
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (vetëm për zyrtarët publik)

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 25/03/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 7. Kriteret specifike shtesë

---

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

<https://www.youtube.com/watch?v=olwDDqCUEZI>

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

